LIGJ
Nr.9278, datë 23.9.2004

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS NR.173 TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS "MBROJTJA E PRETENDIMEVE TË PUNËTORËVE NË RAST FALIMENTIMI TË PUNËDHËNËSIT", 1992

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa nr.173 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës "Mbrojtja e pretendimeve të punëtorëve në rast falimentimi të punëdhënësit", 1992.

Neni 2

Republika e Shqipërisë deklaron se do të zbatojë pjesën e dytë të Konventës: "Mbrojtja e pretendimeve të punëtorëve nëpërmjet privilegjit".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4343, datë 11.10.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTA
LIDHUR ME MBROJTJEN E PRETENDIMEVE TË PUNËTORËVE NË RASTIN E FALIMENTIMIT TË PUNËDHËNËSVE TË TYRE

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës,
e thirrur në Gjenevë nga Këshilli Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe mbledhur në sesionin e saj të 79-të më 3 qershor 1992,
duke theksuar rëndësinë e mbrojtjes së pretendimeve të punëtorëve në rastin e falimentimeve të punëdhënësve të tyre dhe duke kujtuar dispozitat lidhur me të, të parashikuara nga neni 11 i Konventës, 1949, Mbrojtja e pagave dhe neni 11 i Konventës, 1925, Kompensimi i punëtorëve (Aksidentet);
duke vënë re se, qysh nga miratimi i Konventës 1949, Mbrojtja e pagave, i është kushtuar një rëndësi më e madhe rihabilitimit të ndërmarrjeve që nuk kanë aftësi paguese dhe që për shkak të pasojave ekonomike dhe sociale të falimentimit, duhet të bëhen përpjekje, nëse është mundësia, për rehabilitimin e ndërmarrjeve dhe ruajtjen e punësimit;
duke vënë re se, qysh me miratimin e standardeve të përmendura më sipër, kanë ndodhur zhvillime të rëndësishme në legjislacionin dhe praktikën e shumë anëtarëve, të cilët kanë përmirësuar mbrojtjen e pretendimeve të punëtorëve në rastin e falimentimi të punëdhënësve të tyre dhe duke gjykuar se është koha që Konferenca të miratojë standarde të reja mbi objektin e pretendimeve të punëtorëve;
pasi ka vendosur mbi miratimin e disa propozimeve, lidhur me mbrojtjen e pretendimeve të punëtorëve në rastin e falimentimit të punëdhënësve të tyre, e cila është pika e katërt e axhendës së

sesionit;

pasi ka vendosur që këto propozime të marrin formën e një Konvente ndërkombëtare, miraton në datën 23.6.1992 Konventën e mëposhtme, e cila mund të quhet Konventa për mbrojtjen e pretendimeve të punëtorëve (falimentimi i punëdhënësit), 1992.

PJESA E 1
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Në kuptim të kësaj Konvente, termi "falimentim" nënkupton situatat në të cilat, në përputhje me legjislacionin dhe praktikën e vendit, kanë filluar procedurat lidhur me pasuritë e punëdhënësit, me qëllim që të rimbursohen kolektivisht kreditorët e tij.

2. Në kuptim të kësaj Konvente, anëtari mund të përfshijë në termin "falimentim" edhe situatat në të cilat pretendimet e punëtorëve për pagesat që ju takojnë nuk mund të plotësohen për shkak të situatës financiare të punëdhënësit, për shembull kur vlera e pasurive të punëdhënësve është e tillë që nuk e justifikon fillimin e procedurave të falimentimit.

3. Masa në të cilën pasuritë e punëdhënësit janë objekt i procedurave të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet nga legjislacioni ose praktika e vendit.

Neni 2

Dispozitat e kësaj Konvente duhet të zbatohen nëpërmjet legjislacionit ose çdo mjeti tjetër në përputhje me praktikën e vendit.

Neni 3

1. Anëtari që ratifikon këtë Konventë duhet të pranojë ose detyrimet e pjesës II, që siguron mbrojtjen e pretendimeve me anën e privilegjit, ose detyrimet e pjesës III, që siguron mbrojtjen e pretendimeve të punëtorëve me anën e institutit të garancisë, ose detyrimet e të dyja pjesëve. Kjo zgjedhje duhet të tregohet në deklaratën shoqëruese të ratifikimit.

2. Anëtari që ka pranuar fillimisht vetëm pjesën II ose vetëm pjesën III të kësaj Konvente mundet që më pas, me anën e një deklarate që i komunikohet Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës, ta shtrijë pranimin e tij për pjesën tjetër.

3. Anëtari që pranon detyrimet e të dyja pjesëve të kësaj Konvente, pas konsultimit me organizatat më të përfaqësuara të punëtorëve dhe të punëdhënësve, mund të kufizojë zbatimin e pjesës III në disa kategori të punëtorëve dhe në disa degë të veprimtarisë ekonomike. Këto kufizime duhet të përcaktohen në deklaratën e pranimit.

4. Anëtari që ka kufizuar pranimin e detyrimeve të pjesës III, në përputhje me paragrafin 3 të mësipërm, në raportin e tij të parë në përputhje me nenin 22 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, duhet të japë arsyet për kufizimin e pranimit të tij. Në raportet vijuese ai duhet të informojë mbi çdo shtrirje të mbrojtjes, sipas pjesës II të kësaj Konvente, në kategori të tjera të punëtorëve ose degë të tjera të veprimtarisë ekonomike.

5. Anëtari që ka pranuar detyrimet e pjesës II dhe III të kësaj Konvente, pas konsultimit me organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve dhe punëmarrësve, mund të përjashtojë nga zbatimi i pjesës II të kësaj Konvente pretendimet që mbrohen sipas pjesës III.

6. Pranimi nga anëtari i detyrimeve të pjesës II të kësaj Konvente përfshin automatikisht heqjen dorë nga detyrimet e tij sipas nenit 11 të Konventës, 1949, Mbrojtja e Pagave.

7. Anëtari që ka pranuar vetëm detyrimet e pjesës III të kësaj Konvente, me anën e një deklarate që i komunikohet Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës mund të heqë dorë nga detyrimet e parashikuara në nenin 11 të Konventës, 1949, Mbrojtja e pagave, në lidhje me pretendimet që mbrohen sipas pjesës III.

Neni 4

1. Përveç përjashtimeve të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, dhe kufizimeve të përcaktuara sipas nenit 3 paragrafi 3, kjo Konventë zbatohet ndaj të gjithë punëmarrësve dhe në të

gjitha degët e veprimtarisë ekonomike.

2. Autoriteti kompetent, pas konsultimit me organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve dhe të punëmarrësve, mund të përjashtojë nga pjesa II, pjesa III ose nga të dyja pjesët e kësaj Konvente kategori të caktuara të punëtorëve, veçanërisht punonjësit publikë, për arsye të natyrës së veçantë të marrëdhënieve të tyre të punës, ose nëse ka tipe të tjera garancie që iu ofron atyre mbrojtje të njëjtë me atë që ju siguron kjo Konventë.

3. Anëtari, duke u mbështetur në përjashtimet e parashikuara në paragrafin 2 më sipër duhet, në raportet sipas nenit 22 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, të informojë mbi këto përjashtime, duke dhënë arsyet përkatëse.

PJESA II
MBROJTJA E PRETENDIMEVE TË PUNËTORËVE ME ANËN E PRIVILEGJIT

Neni 5
Pretendimet e mbrojtura

Në rastin e falimentimit të punëdhënësit, pretendimet e punëtorëve që burojnë nga punësimi duhet të mbrohen nga privilegji, me qëllim që të paguhen nga pasuritë e punëdhënësit të falimentuar përpara se të paguhen kreditorët e tjerë.

Neni 6

Privilegji duhet të mbrojë së paku:

a) pretendimet e punëtorëve për pagat lidhur me një periudhë të caktuar, e cila nuk mund të jetë më e vogël se tre muaj para falimentimit ose para përfundimit të punësimit;

b) pretendimet e punëtorëve për pagesën e pushimeve që ju takojnë si rezultat i punës së kryer gjatë vitit në të cilin ka ndodhur falimentimi ose zgjidhja e marrëdhënieve të punës, si dhe në vitet paraardhëse;

c) pretendimet e punëtorëve për shumat që ju takojnë lidhur me pagesat e padhëna që lidhen me një periudhë të caktuar, e cila nuk mund të jetë më e vogël se tre muaj para periudhës së falimentimit ose përfundimit të punësimit;

d) pagesën e shkëputjes që iu takon punëtorëve në rastin e përfundimit të punësimit të tyre.

Neni 7
Kufizimet

1. Legjislacioni i vendit mund të kufizojë mbrojtjen me anën e privilegjit të pretendimeve të punëtorëve për një shumë të caktuar, e cila nuk mund të jetë nën një nivel shoqëror të pranueshëm.

2. Kur privilegji që gëzojnë pretendimet e punëtorëve është i kufizuar, shuma e caktuar duhet të jetë e tillë që të ruajë vlerën e saj.

Neni 8
Radha e privilegjit

1. Legjislacioni i vendit duhet t’u japë pretendimeve të punëtorëve një radhë më të lartë privilegji të shumicës tjetër të pretendimeve të privilegjuara, dhe veçanërisht atyre të shtetit dhe sistemit të sigurimit shoqëror.

2. Kur pretendimet e punëtorëve mbrohen nga një institut garancie, në përputhje me pjesën III të kësaj Konvente, pretendimeve të mbrojtura në këtë mënyrë mund t’u jepet një radhë më e ulët privilegji se ato të shtetit dhe të sistemit të sigurimit shoqëror.

PJESA III
MBROJTJA E PRETENDIMEVE TË PUNËTORËVE NGA NJË INSTITUT GARANCIE

Neni 9

Parime të përgjithshme

Pretendimet e punëtorëve kundrejt punëdhënësit të tyre për shlyerjen e detyrimeve, të cilat burojnë nga punësimi i tyre, kur shlyerja e tyre nuk mund të bëhet nga punëdhënësi për shkak të falimentimit, duhet të garantohet nëpërmjet një instituti garancie.

Neni 10

Duke i dhënë fuqi kësaj pjese të Konventës, anëtari, pas konsultimit me organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve dhe të punëmarrësve, mund të miratojë masa të përshtashme, me qëllim që të shmangë abuzimin e mundshëm.

Neni 11

1. Organizimi, drejtimi, funksionimi dhe financimi i instituteve të garantimit të pagave duhet të caktohet sipas nenit 2.

2. Paragrafi i mësipërm nuk e ndalon anëtarin, në përputhje me karakteristikat dhe nevojat e tij të veçanta, të lejojë shoqëritë e sigurimeve për të siguruar mbrojtjen e parashikuar në nenin 9, për aq sa ato ofrojnë garanci të mjaftueshme.

Neni 12

Pretendimet e mbrojtura nga instituti i garancisë

Pretendimet e punëtorëve, të mbrojtura sipas kësaj pjese të Konventës, përfshijnë së paku:

a) pretendimet e punëtorëve për pagat lidhur me një periudhë të caktuar, e cila nuk mund të jetë më e vogël se tetë javë para falimentimit ose para përfundimit të punësimit;

b) pretendimet e punëtorëve për pagesën e pushimeve që ju takon si rezultat i punës së kryer gjatë një periudhe të caktuar, e cila nuk mund të jetë më e vogël se gjashtë muaj para falimentimit ose para përfundimit të punësimit;

c) pretendimet e punëtorëve për shumat që ju takojnë lidhur me pagesat e padhëna për një periudhë të caktuar, e cila nuk mund të jetë më e vogël se tre muaj para periudhës së falimentimit ose përfundimit të punësimit;

d) pagesën e shkëputjes që ju takon punëtorëve në rastin e përfundimit të punësimit të tyre.

Neni 13

1. Pretendimet e mbrojtura sipas kësaj pjese të Konventës mund të kufizohen në një masë të caktuar, e cila nuk mund të jetë nën një nivel të pranueshëm social.

2. Kur pretendimet e mbrojtura janë të kufizuara, masa e caktuar të jetë e tillë që të ruajë vlerën e saj.

Neni 14

Dispozita të fundit

Kjo Konventë ndryshon Konventën, 1949, Mbrojtja e pagave në masën e parashikuar në nenin 3 paragarfët 6 dhe 7 të kësaj Konvente, por nuk e mbyll atë Konventë për ratifikim.

Neni 15

Ratifikimi zyrtar i kësaj Konvente duhet t’i komunikohet për regjistrim Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës.

Neni 16

1. Kjo Konventë është e detyrueshme vetëm për ata anëtarë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ratifikimi i të cilëve është regjistruar te Drejtori i Përgjithshëm.

2. Ajo hyn në fuqi dymbëdhjetë muaj pas datës në të cilën ratifikimi i dy anëtarëve është regjistruar te Drejtori i Përgjithshëm.

3. Pas kësaj, kjo Konventë do të hyjë në fuqi për çdo anëtar dymbëdhjetë muaj pas datës në të cilën është regjistruar ratifikimi i saj.

Neni 17

1. Anëtari, i cili ka ratifikuar këtë Konventë, mund ta denoncojë atë pas kalimit të dhjetë vjetëve nga data në të cilën Konventa ka hyrë për herë të parë në fuqi, me anë të një akti që i komunikohet për regjistrim Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës. Ky denoncim hyn në fuqi pas një viti nga data e regjistrimit të tij.

2. Çdo anëtar, i cili ka ratifikuar këtë Konventë dhe që nuk e ushtron të drejtën e denoncimit të parashikuar në këtë nen brenda një viti pas kalimit të periudhës dhjetëvjeçare të parashikuar në paragrafin e mësipërm, do të jetë i detyruar për një periudhë tjetër dhjetëvjeçare dhe pas kësaj mund ta denoncojë këtë Konventë pas kalimit të çdo periudhe dhjetëvjeçare sipas kushteve të parashikuara në këtë nen.

Neni 18

1. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës duhet të njoftojë të gjithë anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për regjistrimin e të gjitha ratifikimeve dhe denoncimeve që i komunikohen atij nga anëtarët e Organizatës.

2. Kur njofton anëtarët e Organizatës për regjistrimin e ratifikimit të dytë që i komunikohet atij, Drejtori i Përgjithshëm duhet t'u kujtojë anëtarëve të Organizatës datën në të cilën Konventa hyn në fuqi.

Neni 19

Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës Ndërkombëtare të Punës duhet t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për regjistrim, në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, veçoritë e plota të të gjitha ratifikimeve dhe akteve të denoncimit që janë regjistruar tek ai në përputhje me dispozitat e neneve të mësipërme.

Neni 20

Këshilli Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës, në kohën që e gjykon të nevojshme, duhet t'i paraqesë Konferencës së Përgjithshme një raport mbi ecurinë e kësaj Konvente dhe të shqyrtojë nevojën e vendosjes në axhendën e Konferencës të çështjes së ndryshimit të plotë apo të pjesshëm të saj.

Neni 21

1. Konferenca miraton një Konventë të re, që ndryshon tërësisht apo pjesërisht këtë Konventë, përveç kur në Konventën e re parashikohet ndryshe:

a) ratifikimi nga një anëtar i Konventës së re sjell denoncimin e menjëhershëm të kësaj Konvente, si dhe të dispozitave të nenit 17 të mësipërm, në qoftë se dhe në kohën kur Konventa e re hyn në fuqi;

b) kjo Konventë do të pushojë së qeni e hapur për ratifikim nga anëtarët në datën kur Konventa e re hyn në fuqi.

2. Kjo Konventë do të mbetet në fuqi në çdo rast në formën dhe përmbajtjen e saj për ata anëtarë, të cilët e kanë ratifikuar atë, por nuk kanë ratifikuar Konventën që e ndryshon atë.

Neni 22

Tekstet anglisht dhe frengjisht të kësaj Konvente kan fuqi të barabartë.